

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKI-Kzz- 152/2012
Data: 23 korrik 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Bertil Ahnberg si kryetar i kolegjit dhe gjyqtarët e Kosovës Marije Ademi dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, në prani të Këshilltarit ligjor të EULEX-it Adnan Isufi duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale P.nr 01/2010 të ish Gjykatës së Qarkut në Pejë, kundër të pandehurit:

B.K. , emri i babait
Komuna e Pejës, shqiptar i Kosovës;

I akuzuar me aktakuzën PP nr. 185/2004 të datës 15 shtator nga Zyra e Prokurorit Publik për kryerjen e veprave penale *Vrasje* në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të Lgjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (tani e tutje KP KSAK), përkatësisht nenit 147 në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tani e tutje KPPK-së), *Vrasje në tentativë* në kundërshtim të nenit 30, (2) të KP KSAK-së dhe nenit 19 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tani e tutje KP RSFJ-së), përkatësisht nenit 147 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së, *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm* në kundërshtim të nenit 157 (1) të KP KSAK-së, përkatësisht nenit 291 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së, *Përdorim i kundërligjshëm i armëve*, në kundërshtim me Rregulloren e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut nr. 2001/7), përkatësisht nenit 328 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së, *Posedim të kundërligjshëm të armëve*, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit (1) dhe (3) të KPPK-së.

I dënuar më 19 shtator 2007 nga Gjykata e Qarkut në Pejë (Kp. nr. 412/2006), pjesërisht e ndryshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 12 janar 2010 (Ap.-Kz. nr. 153/2008), i cili është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Api-Kzi nr 02/2010) të datës 08 qershor 2012 për kryerjen e veprave penale *Vrasje* në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të KP KSAK-së, *Vrasje në tentativë* në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 të KP të KSAK në lidhje me nenin 19 të KP RSFJ-së, *Posedim të kundërligjshëm të armëve*, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7, dhe *Posedim të kundërligjshëm të armëve*, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, dhe është dënuar me njëzeteshtatë (27) vjet burgim.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës M: Hi , në emër të pandehurit B: Kr kundër aktgjykimeve të lartpermendura.

Pas seancës së mbajtur më 23 korrik 2013, sipas neneve 451 dhe 454 dhe 455 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje "KPPK-së") lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës M H në emër të pandehurit B K, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (P nr. 412/2006) të datës 19 shtator 2007, aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 12 janar 2010 (Ap-Kz nr 153/2008) dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (Api-Kzi nr 02/2010) të datës 08 qershor 2012, refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 24 nëntor 2003, rreth orës 08:00, një Njësi e Policisë së Kosovës, e përbërë nga tre Policë S.T. I.H. dhe H.L. është sulmuar në rrugën publike përgjatë inagjistrates Deçan-Pejë.

Një apo më tepër individë të cilët kanë vozitur në afërsi të tyre ka shtënë disa plumba në veturën e viktimave dhe është larguar me shpejtësi. Si rezultat i kësaj, dy Policët S.T. j dhe I.H., janë qëlluar për vdekje, kurse Polici i Kosovës H.L. ka pësuar lëndime të rënda trupore, mirëpo fatmirësisht i ka mbijetuar sulmit.

Më 6 prill 2004, formalisht kanë filluar dhe janë zhvilluar hetimet nga Zyra e Prokurorit Publik Ndërkombëtar kundër disa individëve në lidhje me këtë incident penal.

Më 21 shtator 2006, aktakuza e datës 15 shtator, është ngritur kundër B. K. duke e akuzuar atë për gjoja kryerjen në bashkëkryerje të veprave penale *Vrasje* në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të KP KSAK-së, *Vrasje në tentativë në bashkëkryerje* në kundërshtim të nenit 30 paragrafit 2 të KPPK-së në lidhje me nenin 19 të KP RSFJ-së, *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm i kryer në bashkëpunim* në kundërshtim të nenit 157 paragrafit 1 të KP KSAK-së, *Përdorim i kundërligjshëm i armëve* në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7 të kryer në bashkëpunim, dhe *Posedim të kundërligjshëm të armëve* në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7

Shqyrtimi publik gjyqësor filloi më 15 maj 2007 dhe vazhdoi deri më 19 shtator 2007.

Më 19 shtator 2007, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Qarkut në Pejë me anë të aktgjykimit P. nr. 412/06 ka shpallur të pandehurin B.K. fajtor për *Vrasjen* e Policëve të Kosovës S.T. dhe I.H. në shkelje të nenit 30 paragrafëve 2 dhe 3 të KP KSAK-së, *Vrasjen në tentativë* të Policit të Kosovës H.L. në shkelje të nenit 30 paragrafit 2 të KP KSAK-së në lidhje me nenin 19 të KP RSFJ-së, *Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm* në shkelje të nenit 157 paragrafit 1 të KP RSFJ-së, *Përdorim i kundërligjshëm i armëve* në shkelje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7, *Posedim të*

kundërligjshëm të armëve në shkelej të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7, duke e dënuar atë me 27 (njëzeteshtatë) vjet burgim.

Me anë të aktgjykimit Ap-Kz. nr. 153/08, të datës 12 janar 2010, Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar pikën prej Përdorimit të kundërligjshëm të armëve në Posedim të kundërligjshëm të armëve; dhe pika 3 është shpallur si e absorbuar nga pika 1, kurse aktgjykimi i ankimuar është vërtetuar në pjesën e mbetur.

Aktgjykimi në fjalë i Gjykatës Supreme të Kosovës është apeluar në shkallë të tretë nga avokati mbrojtës i të pandehurit më 22 mars 2010.

Më 6 qershor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës ka lëshuar aktgjykimin Api-Kzz 2/2010, duke refuzuar ankesën si të pabazuar.

Më 28 shtator 2012, avokati mbrojtës *M. t H.* ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të lartpërmendura.

Zyra e Prokurorit të Shtetit (ZPSHK-ja) në mendimi ne saj KLMP II nr. 159/2012, të datës 25 janar 2013, duke iu referuar mendimit të saj të mëparshëm të datës 31 mars 2011 që të konsiderohet si pjesë integrale e mendimit aktual, i ka propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që ta refuzojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar dhe t'i vërtetojë aktgjykimet e apeluara të Gjykatës Supreme të Kosovës.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjatë vlerësimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata Supreme ka gjetur si në vijim:

- a. Kërkesa është e pranueshme pasi që është paraqitur pranë gjykatës kompetente sipas nenit 452 paragrafit 1 dhe brenda afatit kohor sipas nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së.
- b. Gjykata Supreme ka vendosur pas seancës së këshillimit dhe votimit sipas nenit 454 të KPPK-së. Njoftimi i palëve në lidhje me këtë seancë nuk ka qenë i nevojshëm.
- c. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Aktgjykimet në këtë lëndë janë kundërshtuar mbi bazën e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Avokati mbrojtës pretendon në një numër të shkeljeve, shumica prej tyre të ngritura më parë gjatë procedurës së apelit me disa ndryshime të vogla të adaptuara kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të lëshuar në shkallën e dytë.

Gjykata Supreme ka shqyrtuar aktgjykimet e kundërshtuara sipas dispozitave të KPPK-së dhe në pajtim me mendimin juridik të 23 janarit 2013 të Seancës së

Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të mbajtur më 23 janar 2013.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në aktgjykimet e apeluara të lëshuara në shkallët e mëparshme nuk ka nevojë për asnjë intervenim sipas detyrës zyrtare. Sipas nenit 455 të KPPK-së, me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

III. Arsyet e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

1. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të dispozitave të nenit 403 paragrafit 1, pikës 8 të KPPK-së, sepse sipas mbrojtjes aktgjykimet e kundërshtuara bazohen në prova të papranueshme. Avokati mbrojtës pohon se të gjitha provat e mbledhura nga Policia pa urdhër qoftë nga Prokurori apo nga Gjyqtari hetues që nga momenti i ndodhjes së krimit dhe deri në lëshimin e aktvendimit mbi fillimin e hetimeve kundër të dyshuarit janë papranueshme dhe në shkelje të nenit 151 paragrafëve 1 dh 3 dhe nenit 162 paragrafit 4 të Ligjit mbi procedurën penale i cili ka qenë në fuqi dhe i aplikueshëm gjatë kohës materiale.

Gjatë vlerësimit të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me avokatin mbrojtës në lidhje me kompetencat e autoriteteve të policisë për të zhvilluar hetimet dhe në lidhje me ligjshmërinë e rezultatit i cili del nga hetimet.

Në Kosovë, sikurse në cilindo vend tjetër, në mënyrë të pakontestueshme Policia ka autoritet legjitim që të përgjigjet çdoherë kur ka informata se ka ndodhur një krim. Për këtë qëllim, Kodi i Procedurës në fuqi në kohën materiale, si dhe KPPK-ja i cili është zbatuar në fazat e mëvonshme të procedurës përcaktojnë rregullat të cilat policia patjetër duhet t'i respektojë gjatë zhvillimit të hetimeve në mënyrë që të përmbushet qëllimi i hetimeve. Që në njërin anë, është të mbledhin të gjitha informatat të cilat mund të jenë të dobishme për zhvillimin efektiv të procedurës penale, dhe në anën tjetër të parandalojnë ndonjë abuzim eventual të të drejtave të pjesëmarrësve në procedurë dhe/apo të parandalojnë keqpërdorimin e mundshëm të autoritetit të policisë.

As KPPK-ja e as Ligji i procedurës në fuqi në kohën materiale nuk përcaktojnë ndonjë kufizim ligjor për cilëndo palë në procedurë që të paraqesin prova në cilëndo fazë të procedurës nëse provat janë relevante dhe paraqiten sipas rregullave për administrimin e provave.

Në mënyrë që provat të pranohen në procedurë, gjykata duhet të marrë parasysh kushtet ligjore për përdorimin e provave. Që janë, nëse personi kundër të cilit paraqiten provat ka pasur të drejtë dhe mundësinë që ta marrë në pyetje deklaruesin; nëse provat janë marrë dhe prezantuar në pajtim me ligjin; dhe nëse provat e prezantuara janë relevante.

Në lëndën në fjalë, avokati mbrojtës pretendon se thjeshtë për shkak se policia nuk ka marrë urdhër nga Prokurori apo Gjyqtari hetues, provat e mbledhura nga Policia janë *en block* të papranueshme. Nuk ekziston asnjë indikacion, madje nuk pretendohet as nga avokati mbrojtës se Policia në çfarëdo mënyre ka keqpërdorur autoritetin apo ka shkelur të drejtat e të pandehurit gjatë fazës së hetimeve.

Gjatë vlerësimit të pretendimit, kolegji ka gjetur se Policia ka kryer detyrat në mënyrë të duhur dhe i është përmbajtur dispozitave të Kodit të Procedurës gjatë mbledhjes së provave në lidhje me këtë incident penal.

Për më tepër, pavarësisht nga sjellja e Policisë në lidhje me mbledhjen e provave, është e rëndësishme të theksohet se gjykata nuk e ka bazuar aktgjykimin e saj në provat e mbledhura nga Policia.

Në mënyrë të qartë aktgjykimi është bazuar në provat e administruara në mënyrë të duhur dhe të vlerësuara në hollësi gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në lidhje me këtë pikë specifike, neni 157 (1) i KPPK-së përcakton:

“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”.

Është e qartë se dispozita e ligjit kërkon që avokatit mbrojtës dhe të pandehurit t’i jepet mundësia që të kundërshtojnë provat e tilla gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

Nga inspektimi i shkresave të lëndës është kuptuar se në lëndën në fjalë avokatit mbrojtës dhe të pandehurit i janë dhënë mundësi të mjaftueshme që t’i kundërshtojnë provat e prezantuara nga Prokuroria gjatë procedurës së shqyrtimit gjyqësor.

Për më tepër, në fakt, kundërshtimet e njëjta në lidhje me pranueshmërinë janë ngritur më herët nga avokati mbrojtës gjatë procedurës së shkallës së dytë dhe të tretë. Nuk është gjetur asnjë argument i ri në kërkesën për mbrojtën e ligjshmërisë përveç atyre që janë ngritur më parë dhe janë adresuar nga gjykata. Avokati mbrojtës është kufizuar në argumentet e tij thjesht vetëm në aspektin teknik pa ndonjë argumentim substancial. Avokati mbrojtës madje as nuk është munduar që të tregoj se në cilën mënyrë hetimet kanë prekur të drejtat e pjesëmarrësve në procedurë.

Në bazë të dokumentacionit në shkresat e lëndës, në këtë lëndë nuk është vërejtur asnjë shkelje e të drejtës së mbrojtjes të garantuara për të pandehurin sipas ligjit të aplikueshëm. Si rrjedhojë, ky kolegji gjen se argumenti i avokatit mbrojtës është jo meritator.

2. Avokati mbrojtës pretendon se pasi që nuk ka pasur inicim të hetimeve formale deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës, disa deklarata të

dëshmitarëve¹ dhe prova të tjera - si raporti i vendit të krimit i datës 13 dhjetor 2003, raporti i autopsisë i datës 29 nëntor 2003, analiza e ADN-së e datës 6 dhjetor 2003 dhe raporti i vëzhgimit i datës 2 dhjetor 2003, të cilat janë siguruar nga Policia gjatë kësaj periudhe - janë të papranueshme. Më tutje, avokati mbrojtës pretendon se raporti i ekspertit të gjurmëve të gishtërinjve i datës 30 nëntor 2003 është dashur të veçohet nga shkresat e lëndës dhe marrje e re e gjurmëve të gishtërinjve është dashur të urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Mbledhja e provave nuk mund të kufizohet në kohën kur formalisht kanë filluar hetimet kundër individit specifik. Përderisa procedura për mbledhjen e provave zakonisht fillon - dhe patjetër duhet të fillojë - menjëherë pas incidentit dhe/apo sa më parë që autoritetet informohen për krimin, hetimet kundër një individ mund të iniciohen formalisht nga autoriteti kompetent vetëm atëherë kur ekziston "dyshimi i arsyeshëm" se personi ka kryer vepër penale e cila ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare.

Madje edhe kur akoma nuk ka aktvendim mbi fillimin e hetimeve, provat e marra nga Policia në parim mund të përdoren, nëse janë relevante dhe janë marrë në pajtim me rregullat për mbledhjen e provave. Provat mund të përjashtohen vetëm atëherë kur janë marrë me dhunë, shtrëngim, presion apo frikësim etj., në shkelje të ligjit (*pengesa absolute*), dhe kur vlera e tyre provuese në mënyrë të konsiderueshme tejkalohet nga rreziku i paragjykitimit të padrejtë, konfuzioni, çorientimi i gjykatës, vonesa e tepërt apo prezantimi i panevojshëm i provave kumulative pasi që fakti që duhet të provohet është jo relevant apo është provuar me ndonjë provë tjetër etj., që duhet të vlerësohet nga gjykata në bazë të rasteve (*pengesat relative*). Në këtë lëndë nuk ekzistojnë rrethana të tilla.

Në lëndën në fjalë, Gjykata Supreme nuk gjen ndonjë mangësi në aktgjykimin e kundërshtuar në lidhje me vlerësimin e deklaratave të cilat do t'i bënin provat - papranueshmëria e të cilave kërkohet - të papranueshme. Prandaj, Gjykata Supreme është e mendimit se deklaratat e dëshmitarëve si dhe provat e tjera të kundërshtuara janë të pranueshme.

Pavarësisht se argumenti është jo meritator, fakti që gjykata në të vërtetë nuk i ka bazuar aktgjykimet në provat e siguruar nga Policia e bën pretendimin e mbrojtjes jo-relevant. Gjykata Supreme është e mendimit se gjykatat e shkallëve të mëparshme në mënyrë të qartë dhe të shteruar kanë përmendur faktet të cilat ata i kanë konsideruar të provuara dhe të paprovuara, si dhe arsyet e kësaj, dhe në mënyrë specifike kanë treguar provat në të cilat janë

¹ Deklaratat e I.B. e datës 25 nëntor 2003, J.F. e datës 26 nëntor 2003 dhe 10 dhjetor 2003, R.B. e datës 26 nëntor 2003, J.F. e datës 29 nëntor 2003, R.P. e datës 29 nëntor 2003 dhe 10 shkurt 2004, R.P. e datës 24 nëntor 2003 dhe 10 janar 2004, J. e datës 26 nëntor 2003, S.H. e datës 6 shkurt 2004, R.S. (dëshmitari "B") e datës 4 dhjetor 2003 dhe 14 janar 2004, deklarimet anonime "A" deklaratat e datës 20 nëntor 2003, 4 dhjetor 2003 dhe 19 dhjetor 2003, S.F. deklaratat e datës 3 dhjetor 2003, 11 dhjetor 2003, 22 dhjetor 2003 dhe 9 dhjetor 2004, A.P. e datës 24 nëntor 2003, V.H. e datës 24 nëntor 2003, N.L. e datës 17 dhjetor 2003, I.B. e datës 19 dhjetor 2003, A.K. e datës 25 nëntor 2003 dhe 22 dhjetor 2003.

bazuar gjatë lëshimit të aktgjyqimeve. Çfarëdo plotësimi i atij arsytimi është thjesht i tepërt.

Duke iu referuar në mënyrë specifike raportit të autopsisë - në kundërshtim të asaj që është pohuar nga avokati mbrojtës - autopsia në fakt është urdhëruar nga gjyqtari hetues Osman Cucoviq. Në lidhje me pretendimin e mbrojtjes për marrjen e re të gjurmëve të gishtërinjve, duke pasur parasysh se raporti i ekspertit të gjurmëve të gishtërinjve i datës 30 nëntor 2003 do të ishte i papranueshëm, kolegji e konsideron argumentin si të pabazuar. Avokati mbrojtës nuk pretendon në mangësi të raportit të ekspertit e as nuk jep sqarime pse marrja e re e gjurmëve të gishtërinjve ka qenë e domosdoshme.

Ky kolegji gjen se - në kundërshtim të asaj që është pretenduar nga avokati mbrojtës - kur raporti i ekspertit është i qartë, dhe nuk është kontradiktor në mënyrë të konsiderueshme me provat tjera dhe ofron sqarime të mjaftueshme në lidhje me çështjen, çfarëdo kontestimi nuk është vetëm i gabuar por gjithashtu edhe i kotë sepse rrezikon që të shkaktojë më tepër konfuzion sesa sqarim.

Prandaj, Gjykata Supreme gjen se argumentet e avokatit mbrojtës në lidhje me marrjen e gjurmëve të gishtërinjve janë të pabazuara.

3. Avokati mbrojtës pohon se deklarata e dëshmitarit "A" në të cilën është mbështetur gjykata është marrë në shkelje të nenit 156 paragrafit 2 të KPPK-së dhe se gjykata gabimisht ka konstatuar sikur avokati mbrojtës ka dhënë pëlqimin që deklarata e dëshmitarit "A" të lexohet si provë. Avokati mbrojtës pohon se pëlqimi i avokatit mbrojtës (i cili ka vepruar gjatë shqyrtimit gjyqësor) është jo relevant kur prova është marrë në shkelje të rregullave të procedurës. Përndryshe, avokati mbrojtës pohon se në raste të tilla veprimet e avokatit të cilat në mënyrë të qartë bëjnë shkelje të të drejtave të të pandehurit të cilin e përfaqëson, plotësojnë kushtin për përjashtim me zbatimin e nenit 75 paragrafit 4 të KPPK-së.

Gjatë vlerësimit të kësaj pike, kolegji pajtohet me gjykatën e shkallës së mëparshme se dispozitat e Kodit të Procedurës ia mundësojnë gjykatës që të vendos mos të ekzaminoj dëshmitarin nëse palët pajtohen për një gjë të tillë.

Nëse palët pajtohen që ekzaminimi i drejtpërdrejtë nuk është i nevojshëm, pavarësisht nga arsyet që palët në procedurë mund t'i kenë, gjykata mund të vendosë që deklaratat e ekzaminimit të mëparshëm t'i lexoj në procesverbal si prova.

Sidoqoftë, kjo nuk i pengon palët që të paraqesin propozime etj. Palët në procedurë gjatë gjithë procedurës mund të paraqesin kërkesa apo propozime të cilat janë relevante për plotësimin e procedurës së provave.

Përjashtimisht, gjithashtu gjykata sipas detyrës zyrtare mund të propozoj marrjen e provave të caktuar nëse konsiderohet e përshtatshme dhe e domosdoshme. Nëse nuk paraqitet asnjë kërkesë për plotësimin e procedurës së provave apo nëse një kërkesë e tillë është paraqitur dhe është refuzuar, dhe

gjkata gjen se lënda është qartësuar, kryetari i kolegjit shpall përfundimin e procedurës së provave sipas nenit 374 të KPPK-së.

Në lëndën në fjalë, palët janë pajtuar që deklaratat e dëshmitarit "A" të lexohen si prova. Si rrjedhojë, gjykata është përmbajtur nga ekzaminimi i dëshmitarit "A" në bazë të faktit se palët nuk kanë pasur asnjë kundërshtim dhe janë pajtuar që ajo të lexohet. Në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë për të cilën avokati mbrojtës apo i pandehuri kanë pasur kundërshtime në cilëndo fazë të shqyrtimit gjyqësor. Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë provë në shkresat e lëndës, dhe madje as nuk pretendohet nga asnjë palë, që prova është marrë me dhunë, shtrëngim, presion apo frikësim etj., në shkelje të ligjit (*pengesë absolute*).

Avokati mbrojtës ia atribuon mos dëgjimin e dëshmitarit "A" nga gjykata, thjeshtë vetëm mungesës së profesionalizmit të avokatit mbrojtës të caktuar më parë i cili, sipas avokatit mbrojtës, nuk i ka ofruar ndihmë juridike efektive të pandehurit.

Gjatë adresimit të shkeljes të pretenduar të të drejtës për ndihmë juridike efektive, për faktin se (ish) avokati mbrojtës është pajtuar që deklarata e dëshmitarit "A" të lexohet si provë, ky kolegji gjen se është tejet e rëndësishme të theksohet se nuk është detyrë e gjykatës që të ekzaminoj apo vlerësoj strategjinë, as të avokatit mbrojtës e as të prokurorisë.

Gjykata duhet të sigurojë që pala është përfaqësuar në mënyrë efektive dhe që i është dhënë mundësia që të caktoj avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij i cili mund ta përfaqësoj atë me aftësi dhe ekspertizë profesionale e cila përmbush standardin objektiv të ndihmës juridike. Avokati mbrojtës mund të përjashtohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

Në këtë lëndë të veçantë, rrethanat specifike të nevojshme për përjashtimin e avokatit mbrojtës në mënyrë të qartë nuk janë të pranishme. Prandaj, në këtë lëndë nuk është gjetur asnjë shkelje e së drejtës së garantuar për mbrojtje të pandehurit sipas ligjit të aplikueshëm.

4. Avokati mbrojtës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 154 paragrafit 4 të KPPK-së. Në kërkesë është theksuar se gjyqtari për konfirmim ka shpallur me datën 15 dhjetor 2006 provat e caktuara si të papranueshme. Kolegji prej tre gjyqtarëve i Gjykatës së Qarkut ka refuzuar ankesën kundër aktvendimit të lëshuar nga gjyqtari për konfirmim dhe ka pranuar të drejtën për ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 5 nëntor 2007, Gjykata Supreme duke vendosur në lidhje me ankesën kundër aktvendimit të kolegjit prej tre gjyqtarëve ka refuzuar ankesën e Prokurorit dhe ka mbështetur aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim. Avokati mbrojtës tani thekson se ky aktvendim i Gjykatës Supreme është marrë *pas* aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë i cili është lëshuar më 19 shtator 2007. Avokati mbrojtës pohon se kjo është në shkelje të nenit 387 paragrafit 1 të KPPK-së i cili përcakton se gjykata duhet ta bazoj aktgjykimin e saj vetëm në fakte dhe prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjatë adresimit të kësaj pike, ky kolegji e konsideron tejet të rëndësishme të citohet neni 431 i KPPK-së, i cili përcakton si në vijim:

(1) Kundër aktvendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake si dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës së shkallës së parë, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë.

(2) Kundër aktvendimit të kolegjit të përbërë nga tre gjyqtarë nuk lejohet ankesë në procedurën paraprake, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe.

(3) Aktvendimet që merren për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të aktgjykimit mund të kundërshtohen vetëm me ankesë kundër aktgjykimit, përveç kur ky Kod parasheh ndryshe.

(4) Kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk lejohet ankesë.

Në lëndën në fjalë, në bazë të nenit të cituar, aktvendimi i kolegjit prej tre gjyqtarëve i cili mundëson ankesën kundër aktvendimit të tij në Gjykatën Supreme nuk është i lejueshëm sipas ligjit. Sidoqoftë, pranimi i të drejtës për tu ankuar në këtë lëndë, thjesht paraqet një gabim në procedurë të bërë nga gjykata gjë që nuk përbën shkelje substanciale të dispozitave të Kodit të Procedurës. Prandaj, nuk është e domosdoshme që të priset aktgjykimi dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

Për më tepër, shqyrtimi i shkresave të lëndës mundëson konstatimin se nuk janë ndryshuar në mënyrë retroaktive pasojat ligjore (apo statusi) i procedurës e cila ka ekzistuar para pranimit të së drejtës në ankesë. Në fakt, rezultati i aktvendimit të Gjykatës Supreme ka vërtetuar aktvendimet e mëparshme të gjyqtarit për konfirmim dhe të kolegjit prej tre gjyqtarëve.

Prandaj, rrjedha e procedurës nuk është ndikuar në asnjë mënyrë në dëm të të pandehurit.

5. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të dispozitave të Procedurës Penale, përkatësisht të nenit 154 paragrafit 4 të KPPK-së. Sipas mbrojtjes, gjykata ka vendosur që ti pranoj provat e caktuara në veçanti ekspertizën e ADN-së edhe pse provat e tilla më herët janë shpallur të papranueshme nga gjyqtari për konfirmim.

Gjatë adresimit të kësaj pike, që në fillim vlen të përmendet se neni 154 paragrafi 6 i KPPK-së përcakton se *“prova, e cila me aktvendim është konstatuar si e papranueshme, në një fazë të mëvonshme të procedurës me aktvendim mund të konstatohet si e pranueshme”*.

Kjo tregon që provat mund t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykatat në faza të ndryshme të procedurës. Njësoj, aktvendimi i gjyqtarit për konfirmim në lidhje me provat mund t'i nënshtrohet shqyrtimit nga trupi gjykues dhe më vonë në procedurën e apelit. Fakti se sistemi gjyqësor është i organizuar dhe funksionon sipas parimi të hierarkisë, është e nënkuptueshme se përfundimet e gjykatave mund të ndryshojnë. Në rrethanat e rezultateve të ndryshme, sikurse

në këtë rast, aktvendimi i gjykatës më të lartë në hierarkinë e sistemit gjyqësor triumfon.

Provat të cilat janë vendosur me anë të aktgjykimit të formës së prerë, në parim nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit në dëm të të pandehurit. Kështu që të sigurohet siguria juridike për palët dhe për t'iu shmangur parimit të rrezikut të dyfishtë që mund të jetë i aplikueshëm gjithashtu edhe për vlerësimin e provave.

Sidoqoftë, në këtë rast nuk kemi një situatë të tillë për faktin se vendimi i gjyqtarit për konfirmim nuk ka qenë i formës së prerë për procedurën si tërësi. Prandaj, pretendimi i avokatit mbrojtës është i pabazuar.

VI. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, sipas nenit 456 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pkl-Kzz 152/2012, 23 korrik 2013

Kryetar i kolegjit:

Bertil Ahnborg
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:

Adnan Isufi
Këshilltar ligjor

Anëtarët e kolegjit:

Marije Ademi,
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme